



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:146946

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06035972

P.nr.258/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit SH.F. nga komuna e Vushtrrisë dhe të pandehurit H.F. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1137/22, së datës 08.06.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 11.07.2024, i mbajtur në prani të prokurores së shtetit Virtyte Gërvalla, të pandehurit SH.F. dhe H.F. si dhe të dëmtuarit S.O., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 11.07.2024, me datë 09.08.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. I PANDEHURI:

H.F. , nga i ati K., e ëma S. e vajzërisë H., data e lindjes..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 29.05.2022, në fshatin Sllatinë, komuna e Vushtrrisë, ku edhe gjendet shtëpia e të dëmtuarit S.O., në gjendje të aftë mendore, i vetëdijshëm për veprën e tij, ka dashur kryerjen e saj, i vetëdijshëm se vepra e tij është e kundërligjshme, i pandehuri H.F. në prezencën e dëshmitarit SH.F., kanë hyre në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit , i kanë rënë zilës në derë, pas së cilës ka dal i dëmtuari S.O. e të cilit i pandehuri i është drejtuar me fjalët “se nuk kanë me i’ a lanë arën të cilën e ka blerë paraprakisht nga M.T., pasi që kufizohet me patundshmërinë e tyre duke i thënë se nëse edhe njëherë del në atë arë nuk kanë me lënë pa e vra” gjë që te i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe shqetësim, domethënë seriozisht e ka kanosur personin tjetër.

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurin e:

## GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1,200.00 Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet t'a paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar nga gjykata, gjykata do të veprojë sipas nenit 46 të KPRK-se, me zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim, ku njëzet (20) euro të dënimit me gjobë llogariten me një (1) ditë burgim

Obligohet i pandehuri që emër të paushallit gjyqësor t'a paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) Euro dhe në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë në këtë aktgjykimi.

I dëmtuari S.O., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

II.

### I PANDEHURI:

SH.F., nga i ati K., e ëma S., e vajzërisë H., data e lindjes..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme "Gjeologjinë", më parë i pa gjykuar.

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

## REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Me datën 29.05.2022, në fshatin Sllatinë, komuna e Vushtrrisë, ku edhe gjendet shtëpia e të dëmtuarit S.O. , në gjendje të aftë mendore, të vetëdijshëm për veprën e tyre, kanë dashur kryerjen e saj, të vetëdijshëm që vepra e tyre është e kundërligjshme, kanë hyre në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, i kanë rënë ziles në derë, pas së cilës ka dal S.O. e të cilit i janë drejtuar me fjalët "Se nuk kanë me i'a lënë arën të cilën e ka blerë paraprakisht nga M.T., pasi që kufizohet me patundshmërinë e tyre, duke i thënë se nëse edhe njëherë del në atë arë nuk kanë

me lënë pa e vrarë” gjë që si pasojë të i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe shqetësim, domethënë seriozisht e kanë kanosur personin tjetër.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe 31 të KPRK-së

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1137/22, së datës 08.06.2022, kundër të pandehurit SH.F. nga komuna e Vushtrrisë dhe të pandehurit H.F. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm. Gjykata pas kësaj ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë me datën 30.05.2024 në të cilën të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm dhe pastaj në 10.07.2024 janë dhënë fjalët përfundimtare të palëve.

### *Pretendimet e palëve*

Prokurori i Shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se do të vërtetohet se i pandehuri e ka kryer këtë veprë penale dhe atë bazuar në provat e propozuara, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas analizimit në tërësi të shkresave të lëndës, në theks të veçantë procesverbalin e datës 17.10.2023, i përpiluar në këtë gjykatë ku me rastin e procedimit të të dëmtuarit S.O. në cilësinë e dëshmitarit, ku i njëjti ka deklaruar se në pyetjen e prokurorit “ju thoni se i pandehuri i dytë H... të ka thënë se ka me te vra, por i pandehuri i parë Sh.. a te ka kërcënuar, i dëmtuari përgjigjet “ jo Sh. nuk më ka thënë asgjë duke vazhduar unë veten e kam ndjerë të frikësuar nga H.F. i cili më ka thënë se ka mem vra, siç e thashë edhe me lartë “. Duke pasur parasysh këtë deklaram Prokurorja e Shtetit, meqenëse i dëmtuari në mënyrë të qartë ka deklaruar se i pandehuri SH.F. nuk e ka kërcënuar dhe nuk e ka ndjere veten të frikësuar nga ky, Prokurorja e Shtetit pas konsultimit me krye prokurorinë e kësaj prokurorie tërhiqet nga ndjekja penale për të pandehurin SH.F., ashtu që mbetet aktakuza në raport me të pandehurin H.F., i cili është penalisht përgjegjës për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 e lidhur me par.1 ndërsa dispozitivi i aktakuzës tek rreshti i IV fillon me “ i pandehuri H.F. në prezencën e tani dëshmitarit SH.F. kanë hyrë në oborrin e shtëpisë e të dëmtuarit, i kanë rënë ziles në derë, pas së cilës ka dal i dëmtuari S.O. e të cilit i pandehuri është drejtuar me fjalët ..., ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Gjate këtij shqyrtimi gjyqësor pa asnjë mëdyshje e përtej çdo dyshimi të bazuar mirë është provuar se i pandehuri H.F. me datë 29.05.2022, e ka kanosur me jetë të dëmtuarin S.O., kjo është vërtetuar fillimisht nga deklarata e të dëmtuarit S.O., i cili në mënyrë të qartë i ka treguar gjykatës për kërcënimin që i është bërë nga i pandehuri në ditën kritike. Në këtë çështje penale nuk është kontestuese që i pandehuri H.F. ka qenë prezent respektivisht ka shkuar vet

personalisht në shtëpinë e të dëmtuarit lidhur me një pronë, ku edhe i njëjti në shenjë revolte e ka kanosur të dëmtuarin.

Se i njëjti ka qene prezent aty shihet edhe nga deklarata e tani - dëshmitarit SH.F.. Meqenëse në këtë çështje penale i pandehuri H.F. ka zgjedhur te mbrohet ne heshtje, Prokurorja e Shtetit do të thirret në deklaratën e tij të dhënë në polici me datë 30.05.2022, ku i njëjti i është drejtuar te dëmtuarit, pra e pranon që i dëmtuari nuk ka guxuar ta blej atë pronë pasi qe ky vet i pandehuri ka pasur pretendime në raport me atë pronë.

Meqenëse tek vepra penale e kanosjes zakonisht përfshihen deklarime personale të palëve të cilat nuk mund të argumentohen me ndonjë dëshmitar konkret, gjykatës i propozojmë që të i marr parasysh provat tjera rrethanore e që ndërlidhen në mënyrë direkte me motivin e te pandehurit, për ta kanosur të dëmtuarin pasi qe i pandehuri në mënyrë këmbëngulëse pretendon që i dëmtuari nuk ka të drejtë mbi atë pronë dhe nuk është dashur qe marrëveshjen ta bëjë pa folur me të. I njëjti duke shfrytëzuar moshën e shtyrë të të dëmtuarit e shfrytëzon këtë situatë duke i shkuar të njëjtit në shtëpinë e tij duke e kanosur me fjalët siç qëndrojnë në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykatës i propozojmë që të pandehurin H.F. ta shpall fajtor, të i shqiptoj dënim me burgim efektiv për shkak te rrethanave si ne vijim: të merret parasysh shkalla e lartë e dashjes në veprimet e të pandehurit H.F. pasi qe i njëjti e ka konsumuar shkallën direkte me faktin se vet është ai që ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit, pra, nuk ka qenë një takim i rastësishëm por e ka shqetësuar në objektet e tij private, e shtuar këtu edhe vet deklarin e tij në polici ku i njëjti në mënyrë të qartë pa asnjë pikë pendese deklaroi qe nuk e lë të dëmtuarin ta shfrytëzoj pronën, tregon qe përpos shkalles së lartë të dashjes i njëjti nuk ka asnjë pike pendese për veprimet e tij. Rrethanë tjetër rënduese të merret mosha e të dëmtuarit pasi që i njëjti nuk është në gjendje sidomos fizikisht të mbrohet andaj edhe kanosja që i është bërë tek ai ka shkaktuar një ndjenjë më të lartë të frikës dhe shqetësimit qe i është bërë, e meqenëse të njëjtën ligjvënësi e konsideron si rrethanë rënduese, gjykatës i propozojmë që ta ketë parasysh këtë me rastin e marrjes se vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në këtë çështje penale Prokurorja e Shtetit nuk gjen asnjë rrethanë të vetme lehtësuese që mund të i atribuohet të pandehurit andaj meqenëse kemi vetëm rrethana rënduese qëndrojmë pranë propozimit të shqiptimit të dënimit të lartcekur në raport me veprën penale qe i vihet në barrë nga prokuroria.

I dëmtuari në fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurores së Shtetit duke kërkuar edhe kompensimin e dëmit për këtë çështje.

I pandehuri ne fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pretendimet e palës së dëmtuar janë të paqëndrueshme dhe të pavërteta, e ndiej veten plotësisht të pafajshëm dhe jam i gatshëm të i përgjigjem çdo vendimi që e merr gjykata.

*Gjetje e gjykatës lidhur me faktet*

Është fakt jokontestues se të pandehurit dhe i dëmtuari kanë pasur mosmarrëveshje lidhur një paluajtshmërinë e blerë nga i dëmtuari.

Është fakt jokontestues se të njëjtit në ditën kritike kanë shkuar te shtëpia të dëmtuarit për të biseduar për paluajtshmërinë në fjalë.

Këto fakte jokontestuese janë pohuar nga vetë palët.

Kontestuese ishte, nëse i pandehuri H.F. e ka kanosur të dëmtuarin me fjalët *nëse edhe njëherë del në atë arë nuk kemi më lënë pa të vra*.

Meqenëse i pandehuri me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartë cekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave.

#### *Provat e administruara*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë shqyrtuar provat si në vijim:

- Procesverbali i marrjes ne pyetje te dëmtuarit S.O. i datës 30.05.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje i te dyshuarit H.F. i datës 30.05.2022; Procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit SH.F. i datës 30.05.2022; Procesverbali i marrjes ne pyetje te dyshuarit SH.F. i datës 31.05.2022; Raporti policore i policit hetues i datës 30.05.2022; Raporti i oficerit i datës 30.05.2022; Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me nr.ref. 3880/16521/2021

- Në cilësinë e dëshmitarit nga ana e prokurorisë është propozuar i dëmtuari S.O. i cili ka deklaruar se e mbështetë në tërësi deklaratën e dhënë në polici, duke shtuar se me datën 29.05.2022, rreth orës 22:00 kanë ardhur të pandehurit, ku të njëjtit i ka takuar në oborr të shtëpisë së tij, ku të njëjtit ju kanë drejtuar me fjalët a të ka thënë H.F. të mos e blesh këtë pronë dhe se ata nuk do ta lënë t'a punoj arën për shkak se të njëjtit (të pandehurit) e kanë në mexhë, ndërsa dëshmitari i'u ka thënë se unë e kam kontraktuar bagerin që të punoj aty dhe se edhe ju e keni blerë një tokë që unë e kam në mexhë dhe mua nuk më ka penguar kjo. Tutje ka shtuar se i pandehuri H.F. i ka thënë "kemi me t'vra" ndërsa SH. nuk i ka thënë asgjë. Në fund ka shtuar se pronën e ka blerë nga një serb dhe se deri me rastin e blerjes së pronës kanë pasur raporte normale me të pandehurit, mirëpo pas kësaj kanë filluar problemet.

Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëmtuarit S.O. i datës 30.05.2022 shihet se i dëmtuari ka deklaruar se para 5-6 muajve e ka blerë një arë me sipërfaqe rreth 70 ari nga një Serb i fshatit Sllatinë dhe të njëjtën e ka përkthyer në emër të djalit të tij L.O.. Tutje ka deklaruar se me datën 29.05.2022, rreth orës 22:00 derisa i njëjti ishte në shtëpi dy persona nga fshati Bare, Mitrovicë, i kanë trokitur në dritare, ku njëri nga ta ka qenë H.F., djali i K.F., dhe tjetri ka qenë vëllai i tij të cilit i dëmtuari nuk i'a ka ditur emrin, dhe H., i'u ka drejtuar me fjalët "pse ke punuar në tokë të huaj" ndërsa pasi i dëmtuari i ka shpjeguar se të njëjtën e ka blerë dhe e ka përkthyer, H. i

është drejtuar me fjalët “nuk ta la këtë arë se e kam në mexhë” dhe pasi i dëmtuari i është përgjigjur se ara është tij, H. i është drejtuar me fjalët “nëse del në atë arë, dije se pa të vra nuk e la” dhe janë larguar me veturën e tyre, ku pastaj i dëmtuari rastin e ka paraqitur në polici.

- Nga procesverbali i marrjes në pyetje i te dyshuarit H.F. i datës 30.05.2022 shihet se i dyshuari ka deklaruar se me datën 29.05.2022, rreth orës 20:00 së bashku me vëllaun e tij SH.n ka shkuar te shtëpia e S.O.t për t’ a pyetur nëse i njëjti e ka blerë tokën e një Serbi, ku pas përgjigjes së të dëmtuarit se po e ka blerë, ku pastaj H.F. i ka thënë se tokën e kam në mexhë, se është dashtë me biseduar me të njëjtin para blerjes së të njëjtës dhe i njëjti i ka thënë se nuk është dashtë me ble tokën dhe se nuk ta la tokën, ndërsa ka deklaruar se S.O.t nuk i ka thënë se nëse hyn në atë arë pa të vra nuk kam me lanë.

- Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit SH.F. i datës 30.05.2022 shihet se i dyshuari ka deklaruar se me datën 29.05.2022 një person me emrin S.O. kishte punuar në tokën afër mexhës me tokën tonë dhe po atë ditë ne mbrëmje ka shkuar te S.O. i cili i ka thënë se tokën e ka blerë, ndërsa SH.F. i ka thënë se nuk më ke pyetur para se me punu tokën, se unë e kam në Pazar atë tokë, ndërsa S. i ka thënë se arën e kam ble dhe nëse don ti ta shes, ndërsa SH. i’ a ka kthyer se nuk te la me hy aty edhe nëse e ke blerë. Po ashtu nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dyshuarit SH.F. i datës 31.05.2022 shihet se i njëjt ka deklaruar se qëndron prapa deklaratës së dhënë me datën 31.05.2022 dhe ka mohuar ta kenë kanosur të dëmtuarin.

- Nga raporti policor i policit hetues i datës 30.05.2022 shihet se ankuesi S.O. kishte deklaruar se me fqinjën e tij H.F. kishin pas një mosmarrëveshje ku sipas ankuesit, i dyshuari H.F., kishte shkuar te shtëpia e ankuesit ku kanë biseduar për një pronë të cilën ankuesi ka deklaruar se e ka blerë ku i dyshuari i kishte thënë se tokën që e ke blerë ti unë e kam pasur në Pazar dhe ti nuk bënë të hysh e të punosh në atë arë se nëse hyn unë kam me të vra, ndërsa i dyshuari ka pranuar se ka shkuar të shtëpia e ankuesit së bashku me vëllain e tij SH.F.n, por mohon ti ketë thënë ankuesit se nëse shkon në arë dhe e punon kam me të vra.

- Nga raporti i oficerit i datës 30.05.2022 është konstatuar se me datën 30.05.2022, rreth orës 09:00 në Stacionin Policor në Vushtrri ishte paraqitur i dëmtuari S.O. nga fshati Sllatinë, i cili është ankuar se ishte kanosur nga dy persona – vëllezërit H. (K.) F. dhe tjetrit nuk i’ a ka ditur emrin, ku sipas ankuesit personat e dyshuar me datën 29.05.2022 rreth orës 22:00 i kanë trokitur në derë, dhe kur ka dal i njëjti, personat në fjalë i janë drejtuar se “pse punon në arën e huaj” dhe pasi që i njëjti u kishte sqaruar se arën e ka blerë, të njëjtit i kanë thënë “nuk na intereson dhe nëse nesër të takojmë aty besën e ki se kem me t’vra”.

- Në kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër 3880/16521/2021 shihet se shitësi M. T., i’ a ka shitur blerësit L. O. parcelën 00558-0 me sipërfaqe prej 1102m2 dhe parcelën 00559-0 me sipërfaqe prej 6815m2, të cilat gjenden në ZK Sllatinë, komuna e Vushtrrisë.

Të pandehurit H.F. dhe SH.F. gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë zgjedhur të mos deklarohen respektivisht të mbrohen në heshtje.

*Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykata*

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet, dhe atë në bazë të:

- Procesverbali i marrjes ne pyetje te dëmtuarit S.O. në cilësinë e dëshmitaritmë të cilën vërtetohet se me datën 29.05.2022, rreth orës 22:00 kanë shkuar të pandehurit në shtëpinë e ti, ku të njëjtit i ka takuar në oborr të shtëpisë së tij, ku të njëjtit ju kanë drejtuar me fjalët a të ka thënë H. F. të mos e blesh këtë pronë dhe se ata nuk do ta lënë t'a punoj arën për shkak se të njëjtit (të pandehurit) e kanë në mexhë, ndërsa dëshmitari i'u ka thënë se unë e kam kontraktuar bagerin që të punoj aty dhe se edhe ju e keni blerë një tokë që unë e kam në mexhë dhe mua nuk më ka penguar kjo. Tutje ka shtuar se i pandehuri H.F. i ka thënë “kemi me t’vra” ndërsa SH. nuk i ka thënë asgjë. Në fund ka shtuar se pronën e ka blerë nga një serb dhe se deri me rastin e blerjes së pronës kanë pasur raporte normale me të pandehurit, mirëpo pas kësaj kanë filluar problemet.

- Nga procesverbali i marrjes në pyetje i te dyshuarit H.F. i datës 30.05.2022 vërtetohet se i dyshuari ka deklaruar se me datën 29.05.2022, rreth orës 20:00 së bashku me vëllaun e tij SH.n ka shkuar te shtëpia e S.O.t për t'a pyetur nëse i njëjti e ka blerë tokën e një Serbi, ku pas përgjigjes së të dëmtuarit se po e ka blerë, ku pastaj H.F. i ka thënë se tokën e kam në mexhë, se është dashtë me biseduar me të njëjtin para blerjes së të njëjtës dhe i njëjti i ka thënë se nuk është dashtë me ble tokën dhe se nuk ta la tokën, ndërsa ka deklaruar se S.O.t nuk i ka thënë se nëse hyn në atë arë pa të vra nuk kam me lanë.

- Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit Sh. F i datës 30.05.2022 vërtetohet se i dyshuari se me datën 29.05.2022 një person me emrin S.O. kishte punuar në tokën afër mexhës me tokën tonë dhe po atë ditë ne mbrëmje ka shkuar te S.O. i cili i ka thënë se tokën e ka blerë, ndërsa SH.F. i ka thënë se nuk më ke pyetur para se me punu tokën, se unë e kam në Pazar atë tokë, ndërsa S.i ka thënë se arën e kam ble dhe nëse don ti ta shes, ndërsa SH. i'a ka kthyer se nuk te la me hy aty edhe nëse e ke blerë.

- Nga raporti policor i policit hetues i datës 30.05.2022 vërtetohet se ankuesi S.O. kishte deklaruar se me fqinjin e tij H.F. kishin pas një mosmarrëveshje ku sipas ankuesit, i dyshuari H.F., kishte shkuar te shtëpia e ankuesit ku kanë biseduar për një pronë të cilën ankuesi ka deklaruar se e ka blerë ku i dyshuari i kishte thënë se tokën që e ke blerë ti unë e kam pasur në Pazar dhe ti nuk bënë të hysh e të punosh në atë arë se nëse hyn unë kam me të vra, ndërsa i dyshuari ka pranuar se ka shkuar të shtëpia e ankuesit së bashku me vëllain e tij SH.F.n, por mohon ti ketë thënë ankuesit se nëse shkon në arë dhe e punon kam me të vra.

- Nga raporti i oficerit i datës 30.05.2022 vërtetohet fakti se me datën 30.05.2022, rreth orës 09:00 në Stacionin Policor në Vushtrri ishte paraqitur i dëmtuari S.O. nga fshati Sllatinë, i cili

është ankuar se ishte kanosur, ku të njëjtit – të dëmtuarit i kanë thënë “nuk na intereson dhe nëse nesër të takojmë aty besën e ki se kem me t’vra”.

- Nga kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër 3880/16521/2021 vërtetohet se shitësi M. T., i’ka shitur blerësit L. O. parcelën 00558-0 me sipërfaqe prej 1102m<sup>2</sup> dhe parcelën 00559-0 me sipërfaqe prej 6815m<sup>2</sup>, të cilat gjenden në ZK Sllatinë, komuna e Vushtrrisë.

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore, e sidomos gjykata i fali besimin deklarimeve të të dëmtuarit S.O. i cili gjatë gjithë fazave të procedurës kishte deklaruar se është kanosur, pasi që të njëjtat ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrën dhe të njëjtat gjejnë mbështetje edhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ndërsa sa i përket të pandehurit, i njëjti edhe pse kishte mundësi që të ofronte prova që do të vërtetonin pafajësinë e pretenduar të tij, nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka bërë asnjë propozim që do ti kontribuonte këtij qëllimi, ose më saktë në asnjë formë nuk ka arritur ta provoj se nuk ka kryer veprën penale, e gjithashtu edhe pse nuk e pranonte fajësinë dhe është deklaruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i njëjti nuk ka ofruar ndonjë fakt që do të provonte të kundërtën.

Neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale Kanosja, ashtu që theksohet se: *“Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”*. Ndërsa më tutje për formën e kualifikuar të kësaj vepre penale nga paragrafi 2 me të cilën edhe ngarkohet i pandehuri përcaktohet se; *“Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*

I pandehuri përveç që ka mohuar kryerjen e veprës penale, i njëjti nuk ka prezantuar asnjë provë dhe asnjë dëshmitar me të cilat/cilët do të mund të argumentonte para gjykatës të kundërtën e pretendimeve të prokurorisë në aktin akuzues.

Nga provat në shkresat e lëndës dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, u vërtetua mjaftueshëm se i pandehuri ka ndërmarr veprimet ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e aktakuzës, duke e kanosur të dëmtuarin, elemente këto që paraqesin figurën e veprës penale nga neni 181 par.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, andaj të njëjtin gjykata e gjykoj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, të cilin dënim, me pëlqimin e të pandehurit i’ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej njëmijë e dyqind (1,200.00) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.



### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat, por pa u kufizuar si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti nuk ka qenë më parë i gjykuar për ndonjë vepër penale. Ndërsa si rrethana renduese gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ku i pandehuri në orën 22:00 të mbrëmjes kishte shkuar së bashku me vëllain e tij nga fshati Sllatinë kishte shkuar në shtëpinë të dëmtuarit në fshatin Tërllabuq, me ç' rast edhe kishte kanosur të dëmtuarin, pastaj moshën e viktimës – të dëmtuarit, i cili është në moshë të shtyrë, pra mbi moshën 70 vjeçare, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë i gjykuar si dhe si dhe është mbajtur i familjes.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë..

### *Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 dhe nenit 452 të KPPRK-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur konform nenit 462 par. 2 të KPPR-së, në të cilin parashihet që *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”* dhe paragrafi 3 ku është përcaktuar se *“Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente.”*

Lidhur me të pandehurin SH.F., gjykata ka refuzuar aktakuzën e për shkak se Prokurorja e Shtetit në seancën e datës 11.07.2024 është tërhequr nga ndjekja penale, ashtu që gjykata konform nenit 362 paragrafi 1, pika 1.1 ka vendosur që aktakuzën ndaj të pandehurit SH.F. t'a refuzoj.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.258/22, datë 09.08.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.